



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2026



Komuna e Kaçanikut

PROCESVERBAL

Takimi i parë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026

Data: 25.02.2026

Të pranishëm:

- Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës
- Xhelal Dema, Nënkyetar i Komunës
- Arian Teneqja, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
- Emrush Lalinovci, Komandant i Stacionit Policor – Kaçanik
- Vedat Shatri, FSK
- Fatmir Qaka, EVSB
- Elmihane Malsiu, HANDIKOS
- Gazmend Bunjaku, Drejtor i Arsimit
- Naim Hysa, Kryqi i Kuq Komunal
- Ylber Tusha, Përfaqësues i bizneseve
- Diana Muhaxheri, Përfaqësuese e komunitetit
- Shqiponje Vogliqi Rexhepi, KLSP
- Emrin Dema, Këshilli i Prindërve
- Vedat Dema, Zyra për Barazi Gjinore

Munguan:

- Fidaim Fazliu, BIK .
 - Btim Shala, Komiteti për Komunitete .
-

Rendi i ditës:

1. Hapja e mbledhjes
 2. Verifikimi i kuorumit dhe miratimi i rendit të ditës
 3. Propozimi i Koordinatorit të KKSB-së
 4. Raport mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
 5. Formimi i grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026
 6. Të ndryshme
-

1. Hapja e mbledhjes

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës, z. Sabedin Vishi, i cili përshëndeti të pranishmit dhe u uroi mirëseardhje në këtë forum të sigurisë. Njëkohësisht falënderoi përbërjen e mëparshme të KKSB-së për punën e bërë.

2. Verifikimi i kuorumit dhe miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi rendin e ditës, i cili u miratua unanimisht nga të pranishmit.

3. Propozimi i Koordinatorit të KKSB-së

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për KKSB, koordinatori emërohet nga Kryetari i Komunës. Kryetari propozoi dhe emëroi z. Gazmend Bunjaku, Drejtor i Arsimit, si Koordinator të KKSB-së.

4. Raport mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

Kryetari i dha fjalën Komandantit të Policisë, z. Emrush Lalinovci, i cili raportoi:

- Në janar 2026 janë raportuar gjithsej 36 raste, krahasuar me 31 raste në janar 2025.
- Nga këto, 29 janë vepra penale (krahasuar me 24 në vitin paraprak).
- Janë raportuar 7 raste kundërvajtëse, njësoj si në vitin 2025.

Llojet e veprave përfshijnë: lëndim të lehtë trupor, posedim të paautorizuar të armëve, mashtrim, sulm, vjedhje, vjedhje të rëndë, dëmtim të pronës publike, vjedhje të pyjeve, kanosje, ngacmim, posedim të substancave narkotike, dhunë në familje dhe keqtrajtim të fëmijëve.

Diskutime:

- Vedat Dema kërkoi informata më të detajuara për raste të dhunës në familje dhe keqtrajtim të fëmijëve.
- Komandanti sqaroi se për shkak të ndjeshmërisë së rasteve, informatat e detajuara mund të merren vetëm në mënyrë institucionale.
- Emrin Dema ngriti shqetësime për sjelljen e disa zyrtarëve policorë dhe për gjrobat ndaj furnizuesve të bizneseve.
- Komandanti theksoi se çdo ankesë trajtohet dhe, në rast shkeljeje, rastet dërgohen në Inspektoratin Policor të Kosovës.
- Sa i përket parkingut, u theksua se zbatimi i ligjit është obligim dhe bizneset duhet të sigurojnë leje dhe kushte të përshtatshme.
- U theksua gjithashtu prania e policëve me rroba civile në shkolla për parandalimin e dukurive negative.

Dardan Duraku (MPB-DSB) vlerësoi punën e KKSB-së dhe theksoi nevojën për bashkëpunim institucional në parandalimin e dukurive negative, sidomos në shkolla.

5. Formimi i grupit punues për Planin Vjetor 2026

U propozuan këta anëtarë për grupin punues:

- Gazmend Bunjaku
- Elmihane Malsiu
- Diana Muhaxheri

Propozimet u miratuan unanimitisht.

U theksua që plani të hartohet brenda një muaji dhe të dërgohet për miratim në Kuvendin Komunal. Pas miratimit, KKSB do të mbajë mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme

Kryetari njoftoi se pagesat për anëtarët do të vazhdojnë sipas Udhëzimit Administrativ, me rritje sipas përcaktimeve në fuqi, për ata që nuk paguhen nga buxheti i Kosovës.

Dardan Duraku theksoi se Komuna e Kaçanikut është shembull në zbatimin e këtij udhëzimi dhe njoftoi për iniciativë për ndryshimin e tij në nivel qendror.

REKOMANDIME:

1. **Të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional** ndërmjet Policisë së Kosovës, institucioneve komunale, institucioneve arsimore dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim parandalimin e dukurive negative dhe rritjen e sigurisë publike.
2. **Të intensifikohen masat parandaluese nëpër shkolla**, përfshirë vazhdimin e angazhimit të zyrtarëve policorë dhe zhvillimin e aktiviteteve vetëdijësuese për nxënësit.
3. **Të rritet niveli i bashkëpunimit me Qendrën për Punë Sociale**, në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve.
4. **Policia e Kosovës të vazhdojë trajtimin me prioritet të ankesave të qytetarëve** ndaj zyrtarëve policorë dhe, në rastet kur evidentohen shkelje, të ndërmerren veprimet ligjore përkatëse.
5. **Komuna të shqyrtojë mundësitë për rregullimin e hapësirave për parkim dhe furnizim të bizneseve**, me qëllim lehtësimin e qarkullimit dhe shmangien e kundërvajtjeve.
6. **Të vazhdohet zbatimi i Udhëzimit Administrativ për KKSB**, përfshirë edhe kompensimin e anëtarëve sipas dispozitave në fuqi.

Kryesoi: – Kryetari

z.Sabedin Vishi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka